

REPUBLIKA E SHQIPERISE

SHOQERIA " 2-MEC CONTRUCTION " Sh.p.k

AKT THEMELIMI

Tirane , Date 18 Shkurt 2021

A handwritten signature in black ink, consisting of a stylized 'S' followed by a long horizontal stroke.A handwritten signature in black ink, featuring a large, bold 'S' with a long horizontal stroke extending to the right.

Shoqerite e meposhteme , personat fizik dhe shtetasit e listuar me poshte :

- I. **Jetmir Kortoçi** , shtetas shqiptar , me zotesi te plote per te vepruar dhe juridike , mbajtes i dokumentit te identifikimit me numer 033713599 dhe numer personal J 10506048 J lindur me date 06 Maj 1991 , ne qytetin e Bajram Curri dhe banues ne adresen Farke
- II. **Filip Gogaj** , shtetas shqiptare , me zotesi te plote per te vepruar dhe juridike , mbajtes i dokumentit te identifikimit me numer BC 9711814 dhe numer personal J 10606128 E lindur me date 06 Qershor 1991 , ne qytetin e Vlore dhe banues ne adresen Misto Mame .

Sot me date 18 Shkurt 2021 , kane vendosur qe te nenshkruajne Statutin e meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe veprimtaria e saj rregullohet me ane te ketij akti themelimi .



KAPITULLI I

Forma Emertimi , Objekti , Selia dhe Kohezgjatja

NENI 1 : FORMA

- **Shoqeria " 2-MEC CONSTRUCTION " Sh.p.k** , sh.p.k krijohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar , dhe veprimtari e saj rregullohet nepermjet ketij statuti .
- Shoqeria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi
- Statuti i shoqerise eshte ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe ka karate te detyrueshem , ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuar ne te , plotesohen nga legjislacioni shqiptar .

NENI 2 : EMERTIMI

- Emertimi i shoqerise do te jete : **Shoqeria " 2-MEC CONSTRUCTION " Sh.p.k**

NENI 3 : OBJEKTI I SHOQERISE

- Eksport import te mallrave e ndryshem industrial e ushqimore,paisje e pjese elektrike,elektroshtepiake, tregtim me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore si dhe te artikujve te tjere si pije konfeksione,elektronike,fruta,perime,materiale ndertimi prodhime bujqesore e blegtorale,orendi shtepiake ,mobilje, hidrosanitare, hidraulike,tregtim automjetesh te cdo lloji,marke e tonazhi,pjese kembimi per auto,bateri goma,tregtim pllakash,hapje e shfrytezim hotelesh e motelesh,barera e restorante,diskoteka.
- Transport mallrash e pasagjresh,ndertim objektesh social kulturore,rikonstruksion objektesh,ndertim rrugesh auto.,prodhim materiale inerte qeramike,tulla,tjegulla,fajance,ndertim galeri,tunele puse,çpime per uje,punime druri,metali e plastike,xhami dhe instalim e montim i tyre,siperfaqe urbane,mirmbajtje e zhvillim dekorit ne mjedise urbane ndricim sinjalizime.Perdorim te lendeve plasese dhe kurse kualifikimi per perdorim te lendeve plasese .
- Punime topogjeodezike, shpime gjeologo - inxhinjerike, puse çpimi per uje.Punime nentoksores, ura e vepra arti.Punime germimi ne toke,rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasadash,asfaltim rrugesh,ujesjellesa,gazsjellesa,vajsjellesa,vepra kullimi e vaditje,punime per prishjen e ndertimeve,impiante hidrosanitare,kuzhina,lavanteri,mirmbajtje e tyre,sinjalistike rrugore, barriera e mbrojtje rrugore,ndertime parafabrikat beton arme,struktura metalike e druri,punime mbi shina e traversa,ndertime per nen/stacionet,kabinat e transformatoreve,linja te TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise,punime te inxhinjerise se mjedisit,ndertim i impianteve per prodhimin e energjise elektrike punime dhe mbrojtje lumore,sistemime hidraulike dhe bonifikime,diga dhe tunele hidroteknike,ndertime detare e punime thellimi ne uje,impiante teknologjike,termike dhe te kondicionimit,impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni, impiante te brendshme,elektrike,telefoni,radiotelefoni,TV
- Ndertim i impianteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij,ndertimi i impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane, sistemimet kundra zhurmes per infrastrukture,punime strukturore speciale,impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut,pastrim i ujrave detare,liqenore dhe lumore.Ndertim i impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane , riciklimi i tyre , pastrimi i siperfaqeve urbane e gjelberimi i tyre.Zhvillimin e aktivitetit ekonomik ne turizem malor e detare, marrje me qera objekte shtetore, investim e punesim ne keto objekte dhe ndertim objektesh ne funksion te zhvillimit te turizmit. Mirmbajtje Rutine e Dimerore me performnace te akseve rrugore te objekteve te ndertimit te objekteve social kulturore. Importi dhe tregtimi i linjave agroperpunuese, thertore, baxho etj.
- Tregeti te mjeteve kancelarie dhe artikujve industriale.
- Projektim, ndertim, rikonstruksion dhe modernizim te objekteve civile e industriale. Veshje fasadash dhe shtrim rrugesh. Germime ne toke, punime nentoksores, ndertim ura e vepra arti. Ndertim ujesjellsash dhe pastrim uji, ndertim vepra kulluese dhe vaditese. Sipermarje dhe ndertime plotesisht ose pjesisht te veprave publike dhe private. Punime per prishjen e ndertimeve.



- Tregtimin e karburanteve te ndryshme me pakice si vajra lubrifikante te gazit te lengshem per ngrohje, paisje ngrohese gazi si dhe mbushje te bombulave te gazit dhe tregtimin e tyre me pakice.
- Hapje pike lavazhi, servisi, agjenci imobiliare, turistike, tregti paisje elektroshtepiake, artikuj elektrike, kompjutera, printera, fotokopje, artikuj higjeno-sanitare.
- Kancelari

NENI 4 : SELIA

- Selia e shoqerise eshte ne adresen Selia e shoqerise eshte ne adresen : **Rr Riza Abzai - Farke e Vogel , Zona Kadastrale 1605 , Numer Pasurie 536/44**
- Ndryshimi apo transferimi i shoqerise ne nje tjeter adrese do te behet me vendim asambleje apo ortakeve .
- Asambleja e ortakeve mund te vendose hapjen e filialeve , degeve dhe perfaqesuesve te shoqerise ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise .

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTET , NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

NENI 6: KAPITALI THEMELTAR

- Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne vleren 10,000 Lek (Dhjete mije leke) .
- Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 2 (dy) kuota , te gjitha te nenshkruara , me vlere nominale sipas kontributit te ortakeve ne kapitali themeltar te Shoqerise te percaktuara ne nenin 7 te ketij statuti .

NENI 7 : KONTRIBUTET

- Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte ofruar si me poshte :
 - a) **Jetmir Kortoçi** ofron nje kontribut ne para te barabarte me 5,000 Lek , neprmjet depozitimit te kesaj shume ne prane llogarise bankare ne emer te shoqerise ne krijim e siper .
 - b) **Filip Gogaj** ofron nje kontribut ne para te barabarte me 5,000 Lek , neprmjet depozitimit te kesaj shume ne prane llogarise bankare ne emer te shoqerise ne krijim e siper .

Sipas kontributit te dhene :

- a) **Z. Jetmir Kortoçi** i perket nje kuote me vlere nominale 5,000 Lek , ekuivalente 50 % (pesedhjete perqind) te kapitali te shoqerise .
- b) **Z. Filip** i perket nje kuote me vlere nominale 5,000 Lek , ekuivalente 50 % (pesedhjete perqind) te kapitali te shoqerise .

NENI 8 : RITJA E KAPITALIT THEMELTAR

- Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne cdo moment , nje ose disa here , me vendim te asamblese se ortakeve .
- Ne rast te rritjes se kapitali te gjitha ortaket kane te drejten te nenshkruajne rritjen ne raport me vleren nominale te kuotes se kapitali te zoteruar .Ne rast se disa nga ortaket nuk e ushtrojne kete te drejte , pjeset e tyre mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere propocionalisht me vleren nominale te kuotes se kapitali te zoteruar prej tyre .

NENI 9 : ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR

- Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themlatr te shoqerise me vendim te asamblese se ortakeve , duke mos kaluar kufijte e percaktuar ne ligjin per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare .
- Zvogelimi i kapitali perballohet nga secili prej ortakeve ne te njeten mase me vleren nominale te kuotes se kapitali te zoteruar prej tyre .




NENI 9 : TRANSFERIMI I KUOTAVE

- Kuotat jane lehtesisht te transferueshme ndermjet ortakeve
- Ne cdo rast te transferimit te kuotave , ne cfare do lloj forme (shitje apo dhurim) ne favor te subjekteve apo individeve te tjere te ndryshem nga ortaket , kuotat duhet me pare ti ofrohen ne parablerje ortakeve te tjere.
- Ne nje rast te tille , ortaku qe do te transferoje kuoatat e tij duhet te njoftoje ortaket e tjere me leter rekomande dheme kthim pergjigje duke shenuar cmimin e shitjes , modalitetet e shitjes , kushtet , emrin e bleresit dhe afatet e transferimit . E drejta e para blerjes duhet ti ofrohet te gjithë kuotes te ofruar per shitje .
- Ortaket kane nje afat per 15 dite nga marrja e letres rekomande , per ti komunikuar ortakut qe transferon kuoatat , synimin e tyre per te ushtruar apo jo te drejten e parablerjes . Ne rast te mos kthimit te pergjigjes ne afatin e caktuar , prezumohet se ortaket kane hequr dore nga e drejta e parablerjes .
- Ne rast se oferta pranohet nga disa ortaket , kuota e ofruar nga ortaket qe transferon ate , do te ndahet midis ortakeve pranues , ne te njeten mase me vleren nominale te kuotes se kapitalit qe ata zoterojne , pervec rastit kur ka nje marreveshje te kundert. Ne asnje rast pranuesi i offertes nuk mund te ushtroje pjesisht te drejtes e parablerjes .
- Ne rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes , kuotat mund te tu transferohen te treteve plotesisht apo pjesisht , me vendimin e Asamblese se Ortakeve.
- Ne rast te transferimit te kuotave per shkak trashigime *mortis cause* ortaket e tjere kane te drejten te shprehin pelqimin per ortaket e rinj . Ne rast te mos dhenies se pelqimit , mund tu transferohen te treteve plotesisht apo pjesisht , me vendim pozitiv te Asamblese se Ortakeve me shumice te thjeshte .



NENI 10 ADMINISTRIMI

- Shoqeria administrohet nga te pakten 1 administrator i cili qendron ne detyre deri ne shkarkim te tij apo doreheqje per nje periudhe 3 vjecare . Administratori emerohet nga Asambleja e Ortakeve me vote unanime .
- Perfaqesimi ligjor i Shoqerise i besohet administratorit , i cili mund te ushtroje te gjitha kopetencat konform me sa parashikohet ne nenin 95 te ligjit Nr 9901 Date 14 .04.2008 “ Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare “
- Do te jete i nevojshem autorizimi parapark i ortakeve me vendim qe do te merret me voten pro t ortakeve qe perfaqesojne te pakten 71 % (shtatedhjete e nje perqind)te kapitalit themeltar per permbushjen e akteve ne vijim :
 - Marrja e Kredive , garancite dhe celjen e linjave te kredise ne pergjithesi prane cdo instituzioni financiar ose ndermejetes kredie , lidhjen e kontratave me objekt operacionefinanciare dhe / ose ekonomike , blerje apo sherbime me apo pag aranci me vlere me te madhe se 15,000 euro (Pesembedhjete mije euro) ose ne vleren equivalente ne nje tjeter monedhe .
 - Shitbkerja , nenshkrimi i kontributeve dhe dhenia me qera e ndermarrjes ose filialeve te saj .
 - Themelimi i shoqerive te cdo lloj tipi , i bashkimit te shoqerive dhe enteve kolektive te cdo tipi .
 - Blerja dhe shitja e pjesemarrjeve apo interesave te cdo lloji .
 - Blerja , shitja dhe dhenia me qera e pasurive te luajtshme dhe te pa luajtshme te regjistruara .

Administratori /ret mund te emerojne perfaqesues te vecante apo te posacem per veprime apo kategori te caktuara veprimesh .

Me vendim te Asamblese se Ortakeve , administrator te shoqerise do te jete

Z .Jetmir Uke Kortoçi ,shtetas shqiptar me zotesi te plote per te vepruar dhe juridike , mbajtes i dokumentit te identifikimit ose numer personal **J 10506048 J**, **lindur ne Bajram Curri , date 06 Maj 1991** per nje periudhe 5 vjecare , duke filluar nga data : 18 / 02 / 2021 .

Z. Jetmir Kortoçi

Z Filip Gogaj

JETMIR KORTOÇI


Filip Gogaj
